

ANALIZË GJINORE MBI KULTURËN, RININË, DHE SPORTIN NË KOMUNËN E VITISË

Data: Prill, 2023

Table of Contents

Hyrje	2
Mekanizmat ligjor dhe institucionale të barazisë gjinore	4
Analizë gjinore përmes aplikimit të metodës 4R	6
I. Reprezentimi	6
Përfshirja në planifikim dhe pariteti gjinor në vendimarrje	6
Mungesa e paritetit gjinor në planifikim:	6
Mungesa e paritetit gjinor në vendimarrje:	8
II. Resurset	8
Trendi i shpenzimeve të buxhetit komunal në kulturë, rini dhe sport	8
Analizë e alokimeve buxhetore nga perspektiva gjinore	9
Trendi i subvencioneve sipas gjinisë gjatë 2019-2022	13
III. Realia	14
IV. Realizimi	15
Rekomandime politikash	15
Rekomandime për objektiva dhe indikatorë gjinorë	16
Konkluzione	16

Hyrje

Në botë, barazia gjinore në sport ka qenë një çështje e rëndësishme publike për dekada me rradhë.¹ Ndërkaq, në Kosovë për shkak të problemeve të shumta sociale dhe ekonomike, sporti

¹ Larsson, H. (2021). "The discourse of gender equality in youth sports: a Swedish example" Journal of Gender Studies.

dhe kultura nuk është se kanë zënë vend prioritar në politikëbërje. Andaj, sfidat dhe problemet në gjithëpërfshirje në sport dhe kulturë mbesin të shumta në të gjitha komunat e vendit.

Në Kosovë, në nivel komune përgjegjës për politika kulturore, rinore dhe sportive është – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, duke përfshirë këtu edhe komunën e Vitisë. Kjo komunë është subjekt i këtij studimi sa i përket integritimit gjinor në politika të kulturës, rinisë, dhe sportit.

Kjo drejtori në komunën e Vitisë nuk ka një plan vjetor të punës, por ka një plan vjetor të shkurtër të mbështetjes financiare për OJQ në të cilën paraqet fushat në të cilën ofrohet mbështetja, objektivat e përkrahjes financiare, numrin e përafërt të organizatave që do të përzgjidhen, shuma e mbështetjes financiare për vitin fiskal, koha e shpalljes, dhe ndonjë informatë shtesë. Poashtu, Ministria e Financave ka rregulloren No.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.² Kjo rregullore zbatohet për secilën organizatë buxhetore që financon projekte dhe programe për OJQ-të duke përfshirë këtu edhe komunat. Në bazë të kësaj rregullore, Komuna e Vitisë përgatit një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të cilën e shpall në ueb-faqen e saj, ndër të tjera.

Ndërkaq, në ueb-faqe të komunës së Vitisë nuk paraqitet ndonjë e dhënë në lidhje me pjesmarrjen e qytetarëve në kulturë apo sport. Poashtu, nuk ka ndonjë dokument përmbledhës mbi gjendjen e kulturës apo sportit në komunë, si dhe pjesmarrjen e të rinjëve. Fatkeqësisht, ka mungesë të dhënash për gratë dhe vajzat e përfshira në sport jo vetëm në nivel lokal, por edhe në nivel nacional.³ Kjo mungesë e të dhënave të ndara sipas gjinisë mbi pjesmarrjen e vajzave/grave dhe djemve/burrave në kulturë dhe sport paraqet sfidë të madhe në përgatitjen e analizave më të thella për të vlerësuar angazhimin e të dy gjinive në këto fusha dhe arsyjet e asaj (mos)pjesmarrje.

Sipas Agjencisë së statistikave kjo komunë ka 46.978 numër të banorëve, nga të cilat 23.287 janë femra dhe 23.700 janë meshkuj, siç mund të shihet në figurën e mëposhtme.

Censusi i Republikës së Kosovës – Regjistrimi 2011		
Republika e Kosovës	Burra	875.900
	Gratë	863.925
	Total	1.739.825
Vitia	Burra	23.700

² E qasshme tek <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>

³ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020- 2024). Objektivi specifik 2.2 Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore.

	Gratë	23.287
	Total	46.987

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës⁴

Duke u bazuar në këto të dhëna dhe disa të dhëna të tjera të marra direkt nga shërbyesit civil në këtë komunë, në vazhdim analizohet përfshirja e femrave dhe meshkujve në kulturë dhe sport, investimet e komunës për kokë banori në sport dhe kulturë, sensitiviteti ndaj gjinisë në thirrjet publike për subvencione, (mos) përfshirja e të dy gjinive në procesin e vendimarrjes për subvencionet komunale, trendin e përgjithshëm ndër vite të ndarjes së buxhetit në sport dhe kulturë, ndër të tjera. Poashtu, në fund paraqitet një grup i rekomandimeve në mënyre që të gjithë qytetarët (vajza, djem, gra dhe burra) të kenë mundësi të barabartë për të përfituar nga buxheti i komunës në kulturë, rini dhe sport. Metodologjia Për përgatitjen e kësaj analize gjinore në komunën e Vitisë kemi aplikuar metodën 4R e cila përfshinë katër elementet e mëposhtme:

(1) Reprerentimi (representation): Tek reprerentimi është analizuar nëse ka pasur një vlerësim të nevojave, si dhe nëse ka pasur paritet gjinor në dy aspekte të rëndësishme siç është vendimarrja dhe planifikimi. (2) Burimet (resources): Tek burimet është analizuar sesi janë shpenzuar ato resurse financiare në komunë për të vlerësuar nëse ka (pabarazi) në ndarje të buxhetit.

(3) Realiteti (realia): Tek realiteti analizohet nëse ka integrim të çështjeve gjinore në intervenim.

(4) Realizimi (realization): Tek realizimi analizohet se çfarë duhet të bëj institucioni përkatës në mënyrë që të përmirësohet gjendja. Konkretisht, analizohet se si mund të ndryshoj ai interventim që të ketë përfshirje gjinore.

Për të aplikuar këtë metodë është bërë hulumtimi nga zyra dhe kontakt direkt me zyrtaren për baraza gjinore si dhe drejtorinë për kulturë, rini dhe sport. Të gjitha të dhënat e paraqitura dhe të analizuarat janë pranuar përmes email-it mas komunikimit të vazhdueshëm me zyrtarët komunal në Viti. Ndërkaq, hulumtimi nga zyra përfshin analizimin e kornizës legjislative dhe obligimet që dalin nga ajo si dhe mekanizmat nacional dhe lokal për barazinë gjinore në Kosove.

Mekanizmat ligjor dhe institucionat të barazisë gjinore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njeh barazinë gjinore si të drejtë themelore. Konkretisht, artikulli i 15 i Kushtetutës thotë “shteti duhet të garantojë barazinë ndërmjet grave dhe burrave dhe të zhvillojë politika për mundësi të barabarta”. Në fund të vitit 2020, Konventa e Stambollit është bërë pjesë e Kushtetutës së Kosovës së përmes votimit me shumicë votash në parlament

⁴ <https://ask.rks-gov.net/media/1613/popullsia-sipas-gjinis%C3%AB-etnicitetit-dhe-vendbanimit.pdf>

të amendamentit nr 26.5 Kjo konventë njihet në botë si instrument ligjor për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e viktimave.

Për më tepër, Kosova ka kornizë ligjore dhe strategjike, si dhe mekanizma institucional në nivel qendror dhe lokal që garantojnë barazinë gjinore. Korniza ligjore për rfishinë pakon e ligjeve për barazi gjinore: ligjin kundër diskriminimit, ligjin për Ombudpersonin, dhe ligjin për barazi gjinore që garantojnë pjesmarrje të barabartë në jetë në publike dhe mbrojtje nga çdo formë diskriminimi.

Ligji për barazi gjinore është në linjë të plotë me Konventën për Eliminimin e Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAË). Ky ligj garanton përfaqësim të barabartë gjinor prej 50% për secilin gjini, në të gjitha organet legjislativë, gjyqësore, ekzekutive dhe organe të tjera publike. Poashtu, artikulli 1.5 i nenit 5 mbi masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, parasheh:

“për rfishirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve.”⁶

Ndërkaq, mekanizmi kryesor institucional që derivon nga ky ligj dhe që ka për qëllim identifikimin dhe hartimin e politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe monitorojnë atë është Agjencia për Barazi Gjinore (Agjenci) në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Kjo Agjenci ka përgatitur Programin Kombëtar për Barazi Gjinore (2020-2024) i cili ka për qëllim që të sigurojë që barazia gjinore të jetë në qendër të të gjitha proceseve transformuese në Kosovë, strukturave, proceseve, politikave, ndër të tjera. Sipas kësaj programi, në Kosovë nuk ka zbatim të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor edhe pse parashihet me Ligjin për barazi gjinore. Pra, buxheti i përgjegjshëm gjinor mbetet vetëm në nivel raportimi të institucioneve, por nuk i obligon ato që të bëjnë ndarjen e resurseve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e të dy gjinive.

Poashtu, ky ligj për barazi gjinore obligon të gjitha komunat dhe ministritë që të caktojnë zyrtarë të përkrahës për barazi gjinore me kapacitete profesionale dhe të ndajnë burime të mjaftueshme nga buxheti për funksionim. Këta zyrtarë, sipas nenit 12, artikulli 2.2 kanë detyrën dhe përgjegjshmërinë të bëjnë përfshirjen e integritetit gjinor dhe buxhetimit në hartimin dhe zbatimin e politikave.

Si përfundim, sipas raportit të shtetit, korniza ligjore në Kosovë garanton mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe është në linjë me standardet evropiane sipas raportit të shtetit.⁷ Por,

⁵ Gazeta e Zyrtare e Republikës së Kosovës. Amendamenti i Kushtetutit të Republikës së Kosovës. E qasshme tek <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31730>

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për barazi gjinore. Neni 5, artikulli 1.5

⁷ Raporti i Kosovës, 2022. Komisioni Evropian. E qasshme tek https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en

në praktikë një pjesë e madhe e kornizës ligjore nuk zbatohet në plotni duke përfshirë këtu integrimin gjinor në politikë dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Analizë gjinore përmes aplikimit të metodës 4R

I. Reprezentimi

Përfshirja në planifikim dhe pariteti gjinor në vendimarrje

Një nga aspektet më të rëndësishme është reprezentimi, pra pjesëmarrja e të dy gjinive në planifikim dhe në vendimarrje të politikës publike lokale në kulturë, rini dhe sport.

Mungesa e paritetit gjinor në planifikim:

Së pari, në thirrjen publike të përvjetshme që bëhet nga komuna e Vitisë, në baze të rregullores MF-NR-04-2017, nuk përmendet askund fjala vajzë/grua apo djalë/burrë. Pra, thirrja publike nuk ngërthen asnjë masë afirmative përkundër faktit se gjinia mashkullore çdo vit ka përfituar pothuajse dyfish më shumë sesa gjinia femërore. Kjo shpërfaqë edhe mungesën e ndonjë analize gjinore në kulturë, rini dhe sport, ku do të mund të identifikoheshin pabarazitë. Ajo që kjo thirrje publike përban është fushat në të cilat jepen subvencionet, dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve, ku duhet dorëzuar aplikimet, kohëzgjatja e aplikimit (dorëzimit të aplikacionit) dhe të ngjashme.

Së dyti, si hap tjetër i rëndësishëm që realizohet para thirrjes publike për subvencione në kulturë, rini dhe sport, janë dëgjimet buxhetore. Gjatë dëgjimeve buxhetore që komuna e Vitisë i realizon me qytetarët e saj, ata kanë mundësinë të shprehin prioritetet e tyre në lidhje me alokimet buxhetore. Ato të dhëna pastaj analizohen nga zyrtarët komunal dhe në bashkëpunim me stafin politik të komunës vendoset linjat buxhetore. Një dimension tejet i rëndësishëm i dëgjimeve buxhetore në mënyrë që ato të jenë gjithëpërfshirëse është edhe pjesëmarrja e vajzave/grave në to. Sipas të dhënave të komunës së Vitisë çdo vit janë organizuar 9-13 takime për dëgjime buxhetore, sic shihet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Pjesëmarrja sipas gjinisë në dëgjime buxhetore

Viti	2019	2020	2021	2022
Nr. takimeve	13	COVID 19- por në formë virtuale janë pranuar disa komente	9	9

Nr. i femrave dhe meshkujve	217 meshkuj	96 femra	17 meshkuj	3 femra	108 meshkuj	56 femra	123 meshkuj	131 femra
% e femrave dhe meshkujve	69%	30.6%	85%	15%	65.8%	34.14 %	48.42%	51.57 %

Sipas të dhënave në tabelën e mësipërme pjesmarrja e gjinisë mashkullore në dëgjime buxhetore është shumë më e madhe krahasuar me gjininë femërore. Që nga viti 2019-2021, pjesmarrja e meshkujve ka qenë dyfish më e madhe sesa e femrave dhe vetëm në vitin e fundit (2022) kemi 51.57% pjesmarrje të femrave në dëgjime buxhetore krahasuar me të meshkujve 48.42%. Por, nëse pjesmarrja për rreth 2% më e madhe e gjinisë femërore në dëgjime buxhetore do të ketë ndikim pozitiv në uljen pabarazisë në subvencione të sportit, mbetet me u vlerësu gjatë vitit 2023.

Sw treti, ka nënperfaqësim të gjinisë femërore në drejtorinë për kulturë, rini dhe sport (DKRS), përgjegjëse për përpilimin e politikave në këtë fushë dhe ndarjen e subvencioneve. Në tabelën në vijim shihet se përgjatë periudhës 2019-2022, gjinia mashkullore është rreth 70% e stafit e stafit në këtë drejtori, përveç vitit të fundit që ka qenë rreth 64%.

Tabla 2. Të dhënat e stafit të DKRS sipas gjinisë

	2019		2020		2021		2022	
Nr. i të punsuarve	16		16		16		17	
	F	M	F	M	F	M	F	M
Meshkuj/Femra	4	11	4	11	4	10	5	9

Për më shumë, të dhënat në tabelën e mëposhtme paraqesin pagat dhe mëditjet për stafin e drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sportit. Rrjedhimisht edhe këto të dhëna shpërfaqin pabarazi, pasi që numri i stafit të gjinisë femërore është shumë më i vogël sic shihet në tabelën 2. Kjo e dhënë është poashtu një indikacion që gjinia mashkullore ka pozitativ më të larta menaxheriale në këtë drejtori. Pra, rreth 3/4 e buxhetit nga pagat dhe mëditjet në këtë drejtori shpenzohen për gjininë mashkullore.

Tabela 3. Pagat dhe mëditjet në drejtorinë për kulturë, rini dhe sport

Viti	Paga dhe mëditje		Pagave dhe mëditje
	Femra	Meshkuj	Total
2019	20.329/26.96%	55.121 73.04%	75.450
2020	20.347 26.98%	55.129 73.02	75.476
2021	21.275/28.42%	54.642 71.56%	75.915

Mungesa e paritetit gjinor në vendimarrje:

Subvencionet në komunën e Vitisë shpërndahen sipas Rregullores MF.4/2017. Kjo rregullore përcakton themelimin e një komisioni prej gjashtë anëtarësh për ndarjen e subvencioneve. Ky komision prej gjashtë anëtarëve përbëhet nga 5 antarë të rregulltë dhe një rezervë në rast të konfliktit të interesit apo mungesës së anëtarëve të rregullt. Sa i përket përbërjes gjinore, komisioni përbëhet nga pesë meshkuj – anëtarë të rregullt dhe 1 femër- anëtare rezervë.

Kjo përbërje gjinore e komisionit për ndarjen e subvencioneve paraqet pabarazi të theksuar në vendimarrje. Pra, komisioni nuk ka asnjë anëtare te rregullt femër - me përjashtim të një anëtareje rezervë -të gjithë janë meshkuj.

II. Resurset

Trendi i shpenzimeve të buxhetit komunal në kulturë, rini dhe sport

Të dhënat nga komuna e Vitisë, përgjatë viteve 2019-2022, tregojnë se në total subvencione për kulturë, rini dhe sport janë ndarë 123,575 Euro. Gjatë vitit 2021 është anuluar konkursi për shkak të COVID, andaj nuk është ndarë fare buxhet. Tabela në vijim paraqet shumat totale ndër vite:

Tabela 4. Buxheti i ndarë ndër vite për kulturë, rini dhe sport në komunën e Vitisë

Viti	2019	2020	2021	2022
<i>Shuma totale</i>	35,175.00	0	38,500.00	49,900.00

Siç paraqitet në tabelën 4., gjatë vitit 2022 është ndarë shuma më e madhe gjatë katër viteve të fundit.

Këto shpenzime paraqiten në tabelën në vijim si % e buxhetit të shpenzuar në secilën fushë dhe të dhënat pasqyrojnë se subvencionet më të mëdha ndër vite janë orientuar në sport, ndjekur nga kultura dhe në fund rinia.

Tabela 5. Subvencionet në kulturë, rini dhe sport si %

Nr.	Buxheti nga viti 2019 - 2022	Shuma e Subvencioneve	Buxheti së:	Shuma në €	Përqindja (%)
1	<i>2019</i>	35,000.00	Kulturë	10,270.00	30 %
			Sport	20,780.00	60%
			Rini	3,325.00	10%
				34,375.00	100%
2	<i>2020</i>	Anulim i Thirrjes/Konkursit,			0

		pas pandemia "Covid 19"			
3	2021	38,000.00	Kulturë	10,000	26%
			Sport	25,000	66%
			Rini	3,000	8%
			38,000.00	100%	
4	2022	50,000.00	Kulturë	18,750.00	38%
			Sport	27,500.00	55%
			Rini	3,650.00	7%
			49,900.00	100%	

Ndërsa sa i përket investimeve kapitale, ka pasur vetëm në sektorin e sportit, por nuk ka pasur në sektorin e kulturës dhe rinisë. Shuma e përgjithshme e investimeve kapitale përgjate viteve 2019-2022 kapin shumën e 1,033,452,52 Euro, siç shihet në tabelën në vijim:

Tabela 6. Investimet kapitale në komunën e Vitisë

Viti	2019	2020	2021	2022
<i>Shuma totale</i>	112,749.20	336,165.05	276,108.17	308,430.10

Në total, subvencione dhe investime kapitale në sektorin e kultures, rinisë, dhe sportit në komunën e Vitisë, përgjatë viteve 2019-2022 janë ndarë 103,468,827 Euro.

Analizë e alokimeve buxhetore nga perspektiva gjinore

Në këtë seksion do të analizojmë subvencionet buxhetore nga perspektiva gjinore për të vlerësuar nëse edhe vajzat edhe djemët e qytetit të Vitisë janë duke përfituar nga këto subvencione dhe nëse ka nevojë për riformulim të këtyre politikave.

2019: Të dhënat në tabelën në vijim paraqesin subvencionet për OJQ-të në vitin 2019 si dhe përbërjen gjinore të OJQ-ve. Pra, disa nga OJQ-të përfituese janë të përbëra vetëm nga meshkujt, disa vetëm nga femrat dhe disa të tjera përbëhen nga të dy gjinitë.

Tabela 7. Subvencionet gjatë 2019 për OJQ-të në komunën e Vitisë

Nr.	Emri i OJQ	OJQ-të sportive	2019	Përbërja gjinore
1	EULOG		2,000.00	<i>M+F</i>
2	KF "Vllaznia" Pozheran	S	10,870.00	M
3	AKV "Vitia"		1,650.00	<i>M+F</i>
4	ShKA "Kemajl Azizi"		1,750.00	<i>M+F</i>
5	KVRL		1,325.00	<i>M+F</i>
6	Tingulli Fest – Gjilan		1,300.00	<i>M+F</i>
7	Shkolla e Futbollit Kosova-Viti	S	750.00	M
8	Q.K "Anamorava"		2,500.00	<i>M+F</i>
9	ShKA "Jonuz Ramadani"		1,920.00	<i>M+F</i>
10	Klubi i Shahut "Vitia"	S	1,150.00	M

11	K. Shenjëtari "Anamorava"	S	1,160.00	M+F
12	Kori i qytetit Viti		1,200.00	M+F
13	Klubi i Gjimmastikës "Halil Alidema"	S	3,000.00	F
14	Klubi i Pingpongut "Vitia"	S	1,000.00	M
15	Reprezentuese e Kosovës në Shenjëtari - Uratë Rama	S	1,200.00	F
16	Reprezentuese e Kosovës në Shenjëtari - Lumturie Rama	S	1,200.00	F
17	Reprezentues i Kosovës në Shenjëtari - Drilon Ibrahim	S	1,200.00	M
Shuma totale për MESHKUIJ			14970 €	
Shuma totale për FEMRA			5400 €	
Shume totale për FEMRA+MESHKUIJ			14805 €	
TOTAL:			35,175	

Siç mund të shihet në tabelën 4., gjatë vitit 2019 kanë qenë përfitues:

- 3 OJQ duke përfshirë këtu edhe klubet sportive më përbërje vetëm të gjinisë femërore;
- 5 OJQ duke përfshirë këtu edhe klubet sportive më përbërje vetëm të gjinisë mashkullore,
- 9 OJQ duke përfshirë këtu edhe klubet sportive më përbërje të përzier gjinore, femra dhe meshkuj (F+M).

Numri i OJQ-ve përfituese me përbërje vetëm nga femra është më i vogël krahasuar me ato OJQ-të me përbërje vetëm mashkullore. Kurse, numri më i madh i OJQ-ve përfituese është ai me përbërje të përzier meshkuj dhe femra. Andaj, për të vërtetuar këtë pabarazi, ne analizojmë si numër dhe përqindje sa buxhet nga subvencionet është shpenzuar për gra në këto klube sportive dhe sa për burra. Në mungesë të të dhënave rreth numrit të saktë të grave dhe burrave për OJQ me përbërje të përzier, atëherë ne kemi ndarë shumën në mënyrë të barabartë për të dy gjinitë.

Siç shihet në tabelën 5., 36.39% e buxhetit është ndarë për gjininë femërore në sport, kulturë, rini kurse 63.6% për gjininë mashkullore në sport, kulturë dhe rini. Shuma e buxhetit komunal e shpenzuar për subvencioneve në kulturë, rini dhe sport për burra është gati dyfish më e madhe për burra krahasuar me gra.

Këto të dhëna paraqesin pabarazi në ndarje të subvencioneve në komunën e Vitisë në vitin 2019.

Tabela 8. Subvencionet e shpenzuara për gra dhe burra në 2019

Viti	Shpenzuar për gra	% e shpenzuar për gra	Shpenzuar për burra	% e shpenzuar për burra
2019	12,802	36.39%	22,372.3	63.6%

2020: Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur subvencione për shkak të COVID 19.

2021: Të dhënat në tabelën në vijim paraqesin subvencionet për OJQ-të në vitin 2019 si dhe përbërjen gjinore të OJQ-ve. Pra, disa nga OJQ-të përfituese janë të përbëra vetëm nga meshkujt, disa vetëm nga femrat dhe disa të tjera përbëhen nga të dy gjinitë.

Tabela 9. Subvencionet gjatë 2019 për OJQ-të në komunën e Vitisë

Nr.	Emri i OJQ	OJQ-të sportiv e	2021	Përbërja gjinore
1	EULOG		1,000.00	M+F
2	KF "Vllaznia" Pozheran	S	15,000.00	M
3	ShKA "Kemajl Azizi"		5,000.00	M+F
4	Q.K "Anamorava"		3,000.00	M+F
5	Kori i qytetit Viti		2,000.00	M+F
6	Klubi i Gjymnastikës "Halil Alidema"	S	1,500.00	F
7	Klubi i Pingpongut "Vitia"	S	1,000.00	M
8	Reprezentues i Kosovës në Shenjëtarë - Drilon Ibrahim	S	500.00	M
9	KF. "Uniteti" Sodovinë J.	S	2,800.00	M
10	KFF. "Presingu" Viti	S	3,500.00	F
11	Hiking Adventure Club "ANGROS" Viti	S	1,200.00	M+F
12	Instituti për Mirëadministrim dhe të Drejta të Njeriut		2,000.00	F
Shuma totale për MESHKUIJ: 19300				
Shuma totale për FEMRA: 7000				
Shume totale për FEMRA+MESHKUIJ: 12200				
TOTAL: 38,500				

Gjatë vitit 2021 kanë qenë përfitues:

- 5 OJQ me përbërje të përzier meshkuj dhe femra
- 4 OJQ me përbërje vetëm të meshkujve
- 3 OJQ me përbërje vetëm të femrave

Në bazë të këtyre të dhënave, OJQ-të me përbërje vetëm femërore janë në numër më pak krahasuar me ato të gjinisë mashkullore si dhe me përbërje të përzier. Andaj, në tabelën vijuese analizojmë shumën e buxhetit komunal të shpenzuar në subvencioneve për OJQ të grave dhe burrave. Konkretisht, 13,100 Euro janë shpenzuar për gra apo 34.02% krahasuar me burra 25,400 Euro apo 65.97%.

Këto të dhëna paraqesin pabarazi të theksuar në ndarjen e subvencioneve ndaj grave dhe burrave në komunën e Vitisë në vitin 2021, ngjashëm sikur në vitin 2019.

Tabela 10. Subvencionet e shpenzuara për OJQ gra dhe OJQ burra në 2021

Viti	Shpenzuar për gra	% e shpenzuar për gra	Shpenzuar për burra	% e shpenzuar për burra
2021	13,100	34.02%	25,400	65.97%

2022: Të dhënat në tabelën në vijim paraqesin subvencionet për 23 OJQ në vitin 2019 si dhe përbërjen gjinore të OJQ-ve. Pra, disa nga OJQ-të përfituese janë të përbëra vetëm nga meshkujt, disa vetëm nga femrat dhe disa të tjera përbëhen nga të dy gjinitë.

Tabela 11. Subvencionet gjatë 2022 për OJQ-të në komunën e Vitisë

Nr.	Emri i OJQ	OJQ-të sportiv e	2022	Përbërja gjinore
1	KF "Vllaznia" Pozheran	S	8,000.00	M
2	AKV "Vitia"		2,200.00	M+F
3	ShKA "Kemajl Azizi"		5,000.00	M+F
4	Q.K "Anamorava"		4200.00	M+F
5	ShKA "Jonuz Ramadani"		1,900.00	M+F
6	Klubi i Shahut "Vitia"	S	1,200.00	M
7	K. Shenjëtari "Anamorava"	S	1,000.00	M+F
8	Kori i qytetit Viti		3,650.00	M+F
9	Klubi i Gjymnastikës "Halil Alidema"	S	2,000.00	F
10	Reprezentues i Kosovës në Shenjëtari - Drilon Ibrahim	S	500.00	M
11	KF. "Uniteti" Sodovinë J.	S	2,900.00	M
12	KFF. "Presingu" Viti	S	1,800.00	F
13	Hiking Adventure Club "ANGROS" Viti	S	2,000.00	M+F
14	Instituti për Mirëadministrim dhe të Drejta të Njeriut		1,300.00	F
15	Shkolla e Futbollit "Presing" Viti		1,600.00	M+F
16	KF. (Futsal) "Vitia" - Viti	S	1,700.00	M
17	OJQ "Politeia" Viti		1,250.00	M+F
18	Shoqata e të Verbeve Gjilan		500.00	M+F
19	Klubi i Basketbollit "Vitia 06"	S	2,100.00	M+F
20	OJQ "NeutruOn" Viti		1,150.00	F+M
21	OJQ "ARENA" Viti	S	2,000.00	M
22	OJQ "Vullnetaret e anamoravës"		1250.00	F+M
23	Klubi Taekëondo & Hapkido Viti	S	1,200.00	M+F
Shuma totale për MESHKUIJ: 16300				
Shuma totale për FEMRA: 5100				
Shume totale për FEMRA+MESHKUIJ: 29000				
TOTAL: 50,400				

Nga buxheti komunal për kulturë, rini dhe sport kanë përfituar:

- 14 OJQ me përbërje të përzier gjinore
- 6 OJQ me përbërje vetëm të gjinisë mashkullore
- 3 OJQ me përbërje vetëm të gjinisë femërore

Numri i OJQ-ve me përbërje vetëm mashkullore është 50% më i madh krahasuar me OJQ-të me përbërje femërore, e dhënë kjo që paraqet pabarazi në ndarjen e subvencioneve.

Për më shumë, në tabelën vijuese kemi analizuar sa është shpenzuar për gra dhe sa për burra. **Të dhënat shpërfaqin pabarazi të theksuar në ndarjen e subvencioneve në kulturë, rini dhe sport, pra 38.8% (19600 euro) të subvencioneve janë shpenzuar për gra krahasuar 61.1% (30800 euro) për burra.**

Tabela 12. Subvencionet e shpenzuara për OJQ grave dhe OJQ burrave në 2022

Viti	Shpenzuar për gra	% e shpenzuar për gra	Shpenzuar për burra	% e shpenzuar për burra
2022	19600	38.8%	30800	61.1%

Trendi i subvencioneve sipas gjinisë gjatë 2019-2022

Treni i subvencioneve përgjate periudhës 2019-2022 pasqyron pabarazi si në numrin e OJQ përfituese, poashtu edhe në buxhetin e ndarë sipas gjinisë. Cdo vitë përfitues pothuajse dyfish më të mëdhenjë janë OJQ me meshkujt/burrat krahasuar me OJQ vajzat/gratë në komunën e Vitisë.

Tabela 13. Shuma totale e shpenzuar për OJQ të grave dhe burrave (2019-2022)

Viti	Shuma totale (Euro)	Shpenzuar për gra (Euro)	% e shpenzuar për gra	Shpenzuar për burra (Euro)	% e shpenzuar për burra
2019	35,175	12,802	36.39%	22,372.3	63.6%
2020	COVID 19- nuk ka pas thirrje				
2021	38,500	13,100	34.02%	25,400	65.97%
2022	50,400	16,000	38.8%	30,800	61.1%

Për më tepër, duke marrë parasysh numrin e popullësisë sipas gjinisë për komunën e Vitisë dhe subvencionet e dhëna për të dy gjinitë, në tabelën e mëposhtme (2019-2022) shihet se komuna ka ndarë shumë më shumë subvencione për kokë banori djalë/burrë krahasuar me vajzë/grua.

Tabela 14. Shpenzimet e komunës për kokë banori

Viti	Për kokë banori	Për kokë banore
------	-----------------	-----------------

	(djalë/burrë)	(vajzë/grua)
2019	0.94 €	0.54 €
2020	COVID 19- ska pasur thirrje	
2021	1.07 €	0.56 €
2022	1.29 €	0.68 €

Shuma e shpenzuar për kokë banori për gjininë mashkullore dhe femërore është rritur nga viti në vit, por ndër vite ka vazhduar me qënë dyfish më e madhe për gjininë mashkullore krahasuar me gjininë femërore, kështu duke shpërfaqur pabarazi në subvencionet që komuna i ndanë për kulturë, rini dhe sport.

III. Realia

Tek analiza e resurseve evidentohet se ndarja e tyre nuk ka qene e barabartë dhe se djemët/burrat kanë qenë ndër vite përfitues me të mëdhenjë të këtyre resurseve financiare. Pra, **shperfaqet një model i pabarazisë në ndarjen e subvencioneve, në procesin e planifikimit dhe në procesin e vendimarrjes, përmes të cilit model gjinia mashkullore është përfituese dyfish apo trefish më e madhe sesa gjinia femërore.**

Nëse vlerësojmë procesin e planifikimit dhe vendimarrjes së këtyre shpenzimeve buxhetore (shih pjesën e reprezentimit) vërejmë se këto procese janë të verbëra sa i përket përfshirjes gjinore, pra këto procese dallojnë shumë pak nevojat e ndryshme të grave dhe burrave andaj edhe arrijnë të përjetësojnë pabarazinë në këtë fushë. Sipas zyrtares për barazi gjinore në këtë komunë, më herët nuk është bërë asnjë analizë gjinore e thellë që trajton pabarazinë në kulturë, rini dhe sport e në baze të së cilës do të mund të ndërtoheshin intervenime për të përmirësuar gjendjen.⁸

Për më shumë, aktiviteti apo intervenimi që në këtë rast është thirrja për subvencione në kulturë, rini dhe sport nuk është e dizajnuar në bazë të ndonjë norme apo stereotipi gjinor që do të vinte në pozitë të pafavorshme vajzat/gratë aplikuese. Ky aktivitet mbi ndarjen e resurseve/thirrje për subvencione është neutral gjinor, pra mbetet i hapur për te dy gjinitë barabartë, por duke mos marr parasysh nevojat dhe mundësitë e ndryshme për pjesëmarrje në sport, që mund të kenë në këtë fushë të dy gjinitë. Një faktor shpjegues për këtë dokument neutral gjinor është mungesa e ndonjë analize gjinore më të thellë e cila do të vinte në pah pabarazinë në ndarjen e subvencioneve. Një arsye për këtë mungesë është mungesa e kapaciteteve brenda komunës për të ndërtuar një analizë të tillë.

Përveç thirrjes për aplikim edhe tek mekanizmi vendimarrës ka mungësë të paritetit gjinor, pra nga 5 anëtarët e rregulltë të gjithë janë të gjinisë mashkullore. Kjo përbërje vetëm me njërin gjini nuk parashihet ne asnjë rregullore të komunës, pra nuk ka diskriminim në legjislacion. Andaj, një

⁸ intervistë me Ibadete Hyseni, Zyrtare për Barazi Gjinore, Komuna e Vitisë. 01 Shkurt, 2023.

faktor shpjegues mundet me qenë dominimi i burrave, ndër dekada, ne pozita vendimarrëse dhe vazhdimësi e këtij modeli pa vetdijë të plotë institucionale.

Si përfundim, asnjë nga proceset apo mekanizmat nuk ka integrim të përfshirjes gjinore në asnjë nga hapat e zhvillimit të politikës komunale në kulturë, rini dhe sport.

IV. Realizimi

Në këtë seksion analizojmë se çfarë mund dhe duhet të bëjnë institucionet në mënyrë që të zbutet kjo pabarazi.

Konkretisht, analiza e të dhënave nga perspektiva gjinore shpërfaq pabarazi të theksuar në ndarjen e subvencioneve në kulturë, rini dhe sport në këtë komunë. Trendi i pabarazisë mbetet i njëjtë përgjatë katër viteve të fundit (2019-2022) dhe shuma e buxhetit të komunës e ndarë për OJQ dhe klube sportive që kanë përbërje vetëm të gjinisë mashkullore është pothuajse dyfish krahasuar me ato OJQ me përbërje vetëm të gjinisë femërore duke përfshirë këtu edhe klubet sportive. Disa nga të gjeturat kryesore dhe rekomandimet paraqiten në vijim.

Rekomandime politikash

Disa nga të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për ndryshim të politikave janë si në vijim:

- Komisioni vlerësues i cili bën ndarjen e subvencioneve dhe i cili është i themeluar në bazë të rregullores MF.4/2017 është i përbërë nga pesë anëtarë të rregullt, tre janë të gjinisë mashkullore dhe dy të gjinisë femërore në vitin 2022, ndërsa për vitet paraprake ka mungesë të dhënash. Neni 8 i rregullores së MF. 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve diskuton mbi përbërjen e këtij komisioni, por nuk paraqet asnjë fjali në lidhje me përbërjen gjinore të komisionit.

Andaj, në mënyrë që të evitohet cdo megjithëpërfshirje gjinore në këtë mekanizem vendimarrës, sugjerohet të shtohet edhe një fjali tek neni 8.3 për të kërkuar gjithëpërfshirje në aspektin gjinor në çdo komision që krijohet për ndarje të subvencioneve.

- *Thirrja publike për mbështetje financiare të entiteteve publike sipas rregullores MF-NR-04-2017* nuk përfshin ndonjë masë afirmative edhe pse të dhënat shpërfaqin pabarazi dyfish apo trefish ndër vite në ndarjen e subvencioneve në kulturë, rini dhe sport në Viti. Andaj, rekomandohet që të integrohet një masë afirmative në këtë thirrje publike në mënyrë që gjinia më pak e përfaqësuar të ketë përparësi gjatë procesit të vlerësimit, në këtë rast gjinia femërore.
- Gjatë procesit të planifikimit, pra gjatë dëgjimeve buxhetore, mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe dihet vetëm numri i përgjithshëm i pjesmarrësve. Andaj rekomandohet që të dhënat rreth pjesmarrjes në dëgjime publike të rruhen të segreguara sipas gjinisë. Për këtë qëllim mund të krijohet një format i rruajtes së të dhënave, në të cilin do të

përfshihej edhe aspekti gjinor. Rruajtja e të dhënave të ndara sipas gjinisë e lehtëson çdo proces të përgatitjes së çfarëdo analize, duke përfshirë është analizën gjinore. Poashtu, pa marrë parasysh ndrrimin e zyrtarëve përgjegjës në komunë apo edhe atyre politik, do të kishte një historik institucional të këtyre të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Rekomandime për objektiva dhe indikatorë gjinorë

Disa nga objektivat, aktivitetet dhe indikatorët për tu ndërmarr nga komuna janë:

Objektiva

- Rritja e përqindjes së femrave/grave të cilat përfitojnë nga subvencionet në sport, kulturë, dhe rini.

Aktivitetet

- Organizimi i një fushate vetdijësuese duke targetuar vajzat dhe gratë për rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete sportive, duke përfshirë këtu klubet e ndryshme sportive.

Indikatorët gjinor

- Rritja e numrit të klubeve sportive që përbehen nga meshkuj dhe femra në së paku 3 gjatë vitit të ardhshëm.
- Rritja e numrit të klubeve sportive që përbehen nga femrat në se paku 3 gjatë vitit të ardhshëm.
- Rritja minimum 20% e subvencioneve për klube sportive të femrave apo të atyre me përfitues të përzier meshkuj dhe femra.

Konkluzione

Ky raport analizon përfshirjen e perspektivës gjinore në politika të kulturës, rinisë, dhe sportit në komunën e Vitisë, përgjatë viteve 2020-2022. Metodologjia e aplikuar për të analizuar integrimin e perspektivës gjinore është 4R. Kjo metodë përfshinë katër dimensione: reprezentimi, resurset, realia, dhe realizimin. Të gjitha të dhënat për këtë analizë janë marr direkt nga shërbyesit civil në komunë në Vitisë dhe nga ueb-faqja e komunës.

Në përgjithësi, analiza e të dhënave përmes metodologjisë 4R të aplikuar në komunë e Vitisë, mbi politikën publike lokale të kulturës, rinisë, dhe sportit, e shpërfaq këtë politikë si politikë lokale të verbër sa i përket integrimin të perspektivës gjinore. Përkatësisht, gjetjet paraqesin një model të pabarazisë në ndarjen e subvencioneve, në paga dhe mëditje, dhe në procesin e vendimarrjes.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e të gjeturave kryesore sipas katër dimensioneve të 4R.

- I. Tek reprezentimi evidentohet mungesë e paritetit gjinor në vendimarrje dhe në planifikim. Tek kjo e fundit, pjesëmarrja e vajzave/grave sidomos në fazën e konsultimeve

publike dhe dëgjimeve buxhetore duhet të rritet. Poashtu, përbërja e komisionit vendimarrës nuk paraqet gjithëpërfshirje në aspektin gjinor në komunë.

- II. Tek resurset shpërfaqet trend i pabarazisë në ndarjen e subvencioneve, ku djemët/burrat janë përfitues më të mëdhenjë krahasuar me vajzat/gratë. Poashtu, paraqitet mungesa e të dhënave të segreguara sipas gjinisë për komponentën e investimeve kapitale në kulturë, rini dhe sport.
- III. Tek realia vërehet se proceset dhe mekanizmat e ndryshëm nuk marrin parasysh mundësitë dhe nevojat e ndryshme që kanë të dy gjinitë në komunë në Vitisë. Për shembull, rregullorja për subvencione trajton njësoj të dy gjinitë, por nuk është e përshtatme dhe nuk trajton nevojat dhe mundësitë e ndryshme që ata/ato mund ti kenë pasur brenda konturave kulturore dhe sociale në shoqëri.
- IV. Tek realizimi paraqitet një grup i intervenimeve të bazura në rezultare që duhet ndërmarrë nga politikë bërësit për të mundësuar aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, rrjedhimisht avancimin e barazisë gjinore në komunë e Vitisë. Së pari, sugjerohet që të ndryshohet rregullorja lokale mbi subvencione për të përfshirë masë afirmative; së dyti, sugjerohet që të shtohet një nen mbi përbërjen gjinore të komisioneve që ndajnë subvencione/grante të rregullores ministrore; së treti, sugjerohet që të dhënat të rruhen të segreguara sipas gjinisë dhe në format të hapur; së katërti, gjithë përfshirja në dëgjime publike dhe buxhetore të jetësohet për të mundësuar gjithëpërfshirje në planifikim.

P.S Analiza wshtw bwrw nw bashkwpunim me Zyrtaren pwr Barazi Gjinore dhe Drejtorinw pwr Kulturw, Rini dhe Sport